



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 04.06.2024

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT BANIMI DHE  
SHËRBIME 2, 4 DHE 5 KATE MBITOKË ME 1 KAT NËNTOKË”, ME  
VENDNDODHJE NË POTAM, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Andi” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbime 2, 4 dhe 5 kate mbitokë me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Potam, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Andi” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 09/05 / 2025